



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-7426
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	06/11/2020
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 724/XI/2020

Datë: 06/11/2020

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), në zbatim të nenit 89 të Ligjit nr. 04/l-125 për shëndetësi, në zbatim të Ligjit nr. 02/l-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, konform Nenit 4 dhe nenit 5, Nenit 12 paragrafit 4 e Nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 30 paragrafi 2.3. të Rregullores Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës së shëndetit publik, nxjerrë:

V E N D I M

për masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID-19

1. Ndalohet hyrja/dalja e qytetarëve dhe automjeteve private prej orës 20:00 të dt.06/11/2020 deri në orën 05:00 të dt. 09/11/2020, në Komunën e Fushë Kosovës, përveç:
 - 1.1. Personelit shëndetësor dhe personelit të sigurisë;
 - 1.2. qytetarëve për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim, dhe shitje të mallrave esenciale ushqim, barna për njerëz dhe kafshë e shpezë);
 - 1.3. operatorëve ekonomik dhe transpoti i lirë i mallrave/shërbimeve për të siguruar funksionimin e zingjirit të furnizimit;
 - 1.4. kompanitë ndërtimore dhe operatorët që kryejnë punë publike;
2. Obligohet Policia e Kosovës në çdo hyrje/dalje të bëjë kontroll rigoroz për parandalimin e përhapjes së infeksionit me COVID-19;
3. Për të gjithë shkelësit e këtyre masave, organet kompetente **obligohen** të shqiptojnë masat ndëshkimore konform Ligjit nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës;
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Arsyetim

Meqenëse në dy javët e fundit kemi rritje të përshpejtuar të rasteve pozitiv me COVID-19, për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes së mëturjes me të cilën do të ngarkoheshin institucionet shëndetësore, kapacitetet spitalore dhe mund të kishim shtim më të madh të rasteve fatale. Duke pasur parasysh këtë rrezik dhe të panjohurat për shpërndarjen e shpejtë të COVID-19 sipas rekomandimeve të IKSHPK-së, më qëllim të mbrojtjes së popullatës nga COVID-19 dhe shmangies së lëvizjeve të qytetarëve nëpër Komunat ku ka rritje të numrit me të infektuar, Ministri i Shëndetësisë, në përputhje me rekomandimet e IKSHPK-së dhe konform Ligjit nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Armend Zemaj
Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Komunës së Fushë Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zëvendësministrave të Msh;
- IKSHPK-së;
- Policisë së Kosovës;
- Inspektoratit sanitar;
- Inspektoratit shëndetësor dhe Inspektoratit farmaceutik;
- Inspektorateve komunale;
- Departamenti ligjor;
- Divizionit për komunikim me publikun;
- QOE-Msh;
- Sekretarisë së Komitetit për Covid-19;
- Arkivit të MSh.